



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.970/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTP “A...” me nr. të biznesit ..., me seli në Malishevë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Xh.K. dhe avokat I.N. nga Prishtina, kundër debitorit F...M... Kosova Sh.p.k, me nr. të biznesit ..., me seli në Prishtinë, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga Zyra ligjore P...J... Sh.p.k me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 203/21, të datë 27.04.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 30.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit F...M... Kosova Sh.p.k, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 203/21 i datës 27.04.2021, lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, në shumën prej 5,048.80 € (borxhi nga faturat nr. 0060/191 dhe nr. 0061/191 të datës 10.06.2019), dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 203/21 i datës 27.04.2021, lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, sa i përket shumës prej 7,904.41 €.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 203/21, të datë 27.04.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturave nr. 0060/191 të datës 10.06.2019; faturës nr. 0061/191 të datës 10.06.2019; faturës nr. 0072/191 të datës 12.07.2019; faturës nr. 0074/191 të datës 13.07.2019 dhe faturës nr. 0307/201 të datës 17.11.2020 duke urdhëruar debitorin t’ia

paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 12,950.21 €, në emër të borxhit kryesor me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat në Kosovë ose përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kontestuar në tërësi Urdhrin për përmbarim, me arsyetimin se debitori i ka përmbarim detyrimet që rrjedhin nga faturat nr. 0060/191 të datës 10.06.2019; faturës nr. 0061/191 të datës 10.06.2019, ndërsa sa i përket faturës nr. 0307/201 të datës 17.11.2020 ka shtuar se e njëjta nuk gjendet në librat financiar e as në ditarin e punës së debitorit, dhe se sipas kartelës së debitorit borxhi i ngelur nga ana e debitorit tek kreditori është në vlerën prej 5,320.35 euro dhe jo ai i pretenduar në propozimin për përmbarim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se nga kontabilisti i firmës janë njoftuar se është bërë një gabim teknik ashtu që është kërkuar përmbarimi edhe në raport me faturat nr. 0060/191 të datës 10.06.2019 vlerë prej 2,751.83 euro faturës nr. 0061/191 të datës 10.06.2019 në vlerë prej 2,296.97 euro, të cilat është e vërtetë se janë paguar nga debitori, e për të cilat nuk ka kërkuar vazhdimin e përmbarimit. Tutje, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit në raport me faturën nr. 0307/201 të datës 17.11.2020, duke theksuar se fatura në fjalë është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt dhe arsyetimi se kinse nuk kanë pasur furnitor nuk qëndron sepse fatura në fjalë është pranuar dhe malli është dorëzuar tek debitori. Me kërkesë që Urdhri Përmbarimor të shfuqizohet në raport me faturat nr. 0060/191 të datës 10.06.2019; faturës nr. 0061/191 të datës 10.06.2019 në vlerë prej 5,048.80 euro ndërsa të mbetet në fuqi në raport me shumën prej 7,901.40 euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit, dhe atë borxhi që rrjedh nga faturat nr. 0060/191 të datës 10.06.2019 në vlerë prej 2,751.83 euro dhe faturës nr. 0061/191 të datës 10.06.2019 në vlerë prej 2,296.97 euro, fakt ky që vërtetohet nga transferet bankare të datës 13.12.2019 dhe 13.02.2020 të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe të cilat pagesa janë pohuar edhe nga ana e kreditorit.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se propësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht propësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që faturat nr. 0060/191 dhe nr. 0061/191 të datës 10.06.2019 kanë humbur efektin e tyre juridik pas përmbushjes nga ana e debitorit.

Meqenëse në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, duke u bazuar në nenin 66 par. 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon propësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, Gjykata e përfundoi pjesërisht procedurën e përbarimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesërishtme të kredisë në të holla të palës kreditore.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përbaruesit privat P.nr. 203/21, të datë 27.04.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 7,901.40 euro me arsyetimin si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumta dhe koha e*

përbushjes së detyrimit monetar “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se dokumentet – fatura nr. 0072/191 të datës 12.07.2019; fatura nr. 0074/191 të datës 13.07.2019 dhe fatura nr. 0307/201 të datës 17.11.2020 përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, koha e përbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përbushje nga ana e debitorit, e po ashtu e njëjta është pranuar nga debitori, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit, andaj Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor lidhur me detyrimin që rrjedh nga këto fatura.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.970/22, datë 30.03.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

